

Miratohet Programi Shtetëror për Mbështetje në Fuqizimin dhe Angazhimin e Diasporës Shqiptare



Me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 419, datë 27/05/2020 "Për miratimin e programit shtetëror për mbështetje në fuqizim dhe angazhim të diasporës shqiptare". Programi ka për qëllim të zgjerojë mundësitë socio-ekonomike dhe perspektivat për gratë dhe burrat në Shqipëri, si dhe të përmirësojë jetesën e tyre duke rritur nivelin e angazhimit të Diasporës shqiptare. Realizimi i programit do të arrihet përmes bashkëpunimit të Ministrisë së Shtetit për Diasporën me institucionet qeveritare të niveleve të ndryshme me qëllim zhvillimin e instrumenteve për t'u angazhuar në mënyrë aktive me anëtarët dhe organizatat e Diasporës. Gjithashtu, bashkë do të harmonizojnë strategjitë e zhvillimit me Strategjinë e Diasporës Shqiptare, do të ofrojnë shërbime më të mira dhe më të shumta në numër për anëtarët e diasporës, dhe do të nxisin iniciativat e komunitetit për të tërhequr njohuritë dhe investimet e diasporës. Përmes transferimit të njohurive dhe aftësive nga partnerët e diasporës, do të mundësohet rritja e investimeve të përbashkëta me sektorin privat në Shqipëri, duke krijuar kështu vende të reja pune. Ky program shtetëror do të marrë në konsideratë të gjithë faktorët e rëndësishëm dhe do të zbatohet masa për të siguruar angazhimin e pavarur të të gjithë anëtarëve të Diasporës.

Programin e plotë mund ta lexoni [këtu](#).

Mblidhet grupi ndërinstitucional i punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit



U zhvillua mbledhja e parë e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit, krijuar me Urdhrin Nr. 53, datë 9.4.2020 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit". Qëllimi i mbledhjes ishte hartimi i një programi pune lidhur me detyrat e grupit, mbi bazën e propozimeve e diskutimeve nga anëtarët e tij, për rishikimin e masave të Planit të Veprimit, të cilat do të paraqiten për miratim brenda muajit qershor 2020. Grupi kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe në përbërje ka zëvendësministrat në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, arsimin, financat, turizmin, punët e brendshme, drejtësinë, shëndetësinë, bujqësinë, kulturën; përfaqësues të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Akademisë së Shkencave; dhe titullari i INSTAT-it dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Qendra e Botimeve për Diasporën, mbledhje online me përfaqësuesit e mësuesve në Angli dhe në SHBA



Qendra e Botimeve për Diasporën në vijimësi të mbledhjeve të organizuara online me drejtuesit dhe përfaqësuesit e lidhjeve të mësuesve në diasporë, me qëllim marrjen e informacionit dhe zgjidhjes së problematikave të lindura nga situata e re e krijuar prej gjendjes së pandemisë globale, zhvilloi mbledhjet me mësuesit e gjuhës shqipe në Angli, SHBA dhe përfaqësues të QBD-së, nën drejtimin e znj. Mimoza Hysa. Këto mbledhje shërbyen për të njohur problematikave të mësimit në Diasporë dhe për bashkërendimin e punës për të ndihmuar procesin e organizimit të mësimit të gjuhës shqipe. Palët diskutuan gjithashtu ruajtjen e komunikimit dhe zhvillimit të mbledhjeve online në të ardhmen si një ndihmesë për diskutimin dhe zgjidhjen e problematikave të krijuara. Mbledhjet do të vijojnë edhe me përfaqësuesit dhe drejtuesit e lidhjeve të mësuesve në vendet e tjera.

Rikujtesë mësuesve të gjuhës shqipe në Diasporë

Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Postën Shqiptare ka shpërndarë 12.000 tekste mësimore për mësuesin e gjuhës shqipe, në 19 shtete:

Shpërndarja e teksteve mësimore

- në Greqi 4060 tekste,
- në Itali 3681 tekste,
- në Slloveni 460 tekste,
- në Republikën Çeke 60 tekste,
- në Rumani 50 tekste,
- në SHBA 1348 tekste,
- në Belgjikë 130 tekste,
- në Angli 900 tekste,
- në Turqi 100 tekste,
- në Kroaci 60 tekste,
- në Poloni dhe Ukrainë 180 tekste,
- në Gjermani 91 tekste,
- në Francë 261 tekste,
- në Austri 30 tekste,
- në Finlandë 40 tekste,
- në Norvegji 295 tekste,
- në Kanada 68 tekste,
- në Spanjë 50 tekste.


Përgjatë vitit të parë të punës së saj, Qendra e Botimeve për Diasporën, realizoi një mision të rëndësishëm të përmasave mbarëshqiptare: pajisjen me tekste mësimore të gjuhës e kulturës shqiptare të shkollave të gjuhës shqipe në Diasporë. Falë një pune intensive dhe të përkushtuar, bashkëpunimit të suksesshëm ndërinstitucional me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrisë së Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, u arrit për herë të parë dhe në kohë rekord pajisja me 12.000 tekste mësimore të nxënësve në 19 shtete të ndryshme, për vitin shkollor 2019-2020. Veç kësaj, QBD-ja bëri të mundur edhe pajisjen me tekste materiale plotësuese në gjuhën shqipe, të përzgjedhura me kujdes dhe posaçërisht për fëmijët shqiptarë në Diasporë. Për vitin shkollor 2020-2021, Qendra e Botimeve për Diasporën, në kuadër të pajisjes në kohën e duhur të nxënësve në Diasporë me tekste mësimore dhe materiale plotësuese në gjuhën shqipe, rikujton të gjithë mësuesit në Diasporë se duhet të paraqesin kërkesën e tyre për tekste në selinë diplomatike përkatësisht të vendit ku gjenden, duke saktësuar titujt e teksteve dhe sasinë e nevojshme të tyre. Për katalogun e teksteve mësimore dhe katalogun me libra plotësues për mësimdhënien në Diasporë që ofron QBD-ja për shqiptarët e Diasporës, si dhe për çdo paqartësi a hollësi të mëtejshme mund të na kontaktoni përmes email-it zyrtar të Qendrës së Botimeve për Diasporën: info@qbd.gov.al

KKD / Adriana Fishta-Bejko takim virtual me stafin e shkollës shqipe "Foleja e Shqiponjave"



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe Drejtoresha e Shkollës Shqipe "Foleja e Shqiponjave" në Calgary të Kanadasë, Dr. Adriana Fishta-Bejko, në një takim online, analizoi situatën e mësimdhënies nën ndikimin e pandemisë. Në këtë takim stafi pedagogjik i shkollës diskutoi për mënyrën e mësimdhënies duke nisur nga muaji shtator dhe në varësi të kohëzgjatjes së situatës. Mënyra e mësimdhënies duke nisur nga shtatori dhe në varësi të kohëzgjatjes së pandemisë mund të nisim përmes "Google classroom" dhe mund të vazhdojmë me metodën klasike të të paraqiturit fizikisht në shkollë për mësim ose një kombinim i të dyjave, pra dy herë në muaj të bëhet mësimi në "Google classroom" dhe dy herë në muaj të bëhet mësim në ambientet e shkollës. Do aplikohet për herë të parë metoda e platformës online "Schoolme", thuhet në njoftim.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

ANDROID APP ON Google play

Available on the App Store



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

KKD / Rosario Petta, thirrje në kujtim të Giovanni Falcone



28 vjet më parë u ekzekutua në Palermo gjykatësi Giovanni Falcone nga klani i Cosa Nostra-s. Falcone që ishte simboli i denjë i sistemit të drejtësisë dhe i luftës kundër krimit, u vra teksa ndodhej në makinë me gruan e tij dhe me tre truporjat. Në kuadër të përkujtimit të kësaj ngjarje tronditëse për mbarë vendin, Kryetari i Komunës "Piana degli Albanesi" në Sicili të Italisë, arbëreshi Rosario Petta, i cili është edhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, ka shpërndarë në rrjetet sociale një njoftim sensibilizues, në të cilin u bën thirrje të gjithë banorëve të komunës që drejton: "Ta ngjyrosim me të bardhë qytetin, në mënyrë që të mos harrojmë!". Banorët e "Piana degli Albanesi" do t'i mbulojnë me çarçafë të bardhë ballkonet e tyre dhe do të mbajnë një minutë heshtje, sot në orën 17.58, pikërisht në kohën ekzakte që u vra Falkone. Ky homazh vjen për të kujtuar të gjitha viktimat e masakrave dhe për të gjithë njerëzit që përçojnë parimet e guximit dhe të ndershmërisë.